



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 1425/prot
1

Tiranë, më 26.10.2020

URDHËR

Nr. 290, datë 26.10.2020

PËR

**KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E EKIT TË QITJES SË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 4, nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; germës “f”, pikës 2, nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të pikës 1, të nenit 5 dhe pikave 1 dhe 2, të nenit 7, të ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Krijimin e ekipit të qitjes së Forcave të Armatosura me përbërje, si vijon:

- 1) Nënkolonel Gazmend Kulejmani, J/4;
- 2) Nënkolonel Ilir Çerpja, J/4;
- 3) Toger Imelda Murja, Forca Detare;
- 4) Rreshter Sajmir Çekrezi, Forca Ajrore;
- 5) Ushtar Igla Haka, Policia Ushtarake;
- 6) Ushtar Frensi Balla, Policia Ushtarake;
- 7) Tetar Klodiana Panxhi, Reparti 6630;
- 8) Kapter Dorjan Mema, Forca Tokësore;
- 9) Rreshter Alket Plaku, Forca Tokësore;
- 10) Tetar Adelina Hoxha, Forca Tokësore;
- 11) Tetar Emiranda Hajdini, Forca Tokësore;
- 12) Rreshter Alfred Gjylan, Forca Tokësore;
- 13) Rreshter Ervis Hebibasi, Forca Tokësore;
- 14) Tetar Rafael Osmani, Forca Tokësore;

- 15) Tetar Vladimir Haxhiaj, Forca Tokësore;
- 16) Tetar Josif Agolli, Forca Tokësore;
- 17) Rreshter Luan Guxha, Forca Tokësore;
- 18) Rreshter Elez Hidri, Forca Tokësore.

2. Përfaqësues ligjor i ekipit caktohet kolonel Bilbil Bitri, drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes (J-3/7).
3. Pikë kontakti caktohet major Gernat Qirici, J-3/7.
email : gernat.qirici@aaf.mil.al
cel: 00355 67 60 40 846
4. Trajnerë të ekipit do të jenë:
 - a) Nënkolonel Ardjan Gjokoli, J-3/7;
 - b) Major Bledar Mesi, Policia Ushtarake;
 - c) Major Haxhi Shira, Forca Tokësore.
5. Përfaqësuesi ligjor do të ketë këto përgjegjësi dhe kompetenca:
 - a) të përfaqësojë ekipin në marrëdhënie juridike me të tretët;
 - b) të ushtrojë të drejtën e votës në emër të ekipit në rastin e përfshirjes në federata;
 - c) të nënshkruajë marrëveshje me federata dhe klube në të cilat ekipi do të anëtarësohet, me miratimin paraprak të ministrit të Mbrojtjes;
 - ç) në emër të ekipit do t'i drejtohet komandantëve të strukturave, ku pjesëtarët e ekipit të qitjes shërbejnë, duke i kërkuar miratimin në rast se pjesëmarrja në aktivitete ose përgatitja për to do të kërkojë shkëputje nga shërbimi;
 - d) të mos marrë përsipër detyrime financiare, pa marrë miratimin paraprak të autoriteteve vendimmarrëse në MM/SHP.
6. Ekipi i qitjes së Forcave të Armatosura autorizohet të anëtarësohet në federata dhe klube sportive dhe të marrë pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare të qitjes.
7. Çdo angazhim i anëtarëve të ekipit nuk do duhet të pengojë ushtrimin e detyrave dhe operacionalitetin e strukturës ku ai shërben. Angazhimet afatgjata, si marrja pjesë në evenimente ndërkombëtare do duhet të konsultohen paraprakisht me titullarin e strukturës, në të cilën ushtaraku shërben. Pjesëmarrja në aktivitetet sportive përcaktohet me urdhër të veçantë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm.
8. Të gjitha çmimet, subvencionet të përfituara nga ekipi do të shkojnë për plotësimin e nevojave të ekipit dhe do shpërndahen në mënyrë përpjesëtimore ndërmjet pjesëtarëve të ekipit.

9. Përgjigjen për zbatimin e urdhrit: drejtoritë në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komanda e Forcës Tokësore, Detare, Ajrore, Komanda Mbështetëse, Akademia e Forcave të Armatosura, Policia Ushtarake dhe Reparti Ushtarak nr. 6630.
10. Ndjek zbatimin e urdhrit shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

